



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice


Buletini informativ

- **Aktivitetet e përgjithshme**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)**

Mars 2023

Aktivitetet e përgjithshme

Program praktik i dy kandidateve për gjyqtare nga Shkolla e Magjistraturës së Francës në Kosovë



Nga 06-24 mars 2023 dy kandidate për gjyqtare nga Shkolla e Magjistraturës së Francës kanë vijuar programin praktik në institucionet e sistemit të drejtësisë në Kosovë. Ky program praktik është mundësuar nga Ambasada e Franceze në Kosovë si rezultat i vazhdimit të bashkëpunimit të Akademisë së Drejtësisë me Shkollën e Magjistraturës së Francës.

Kandidatet për gjyqtare nga Franca kanë filluar programin praktik në Akademinë e Drejtësisë

me ç' rast janë mirë pritur nga z. Enver Fejzullahu, Drejtor Ekzekutiv dhe znj. Valmira Pefqeli, Udhëheqëse e Programit Fillestar.

Kandidatet gjatë vizitës në Akademi të Drejtësisë janë njoftuar me fushë-veprimtarinë e dhe programet e saj. Gjithashtu kanë marrë pjesë në një sesion të trajnimit fillestar bashkë me prokurorët e gjeneratës së IX të cilët aktualisht ishin duke vijuar sesionet e trajnimit teorik nga moduli i Kodit të Procedurës Penale.

Në vazhdim të këtij programi, kandidatet do të njoftohen edhe me sistemin gjyqësor dhe prokurorial përmes vizitave dhe vëzhgimit praktik të gjykatave dhe prokurorive me thek të veçantë në Prokurorinë Speciale të Kosovës, pasi fokusi ishte tek krimet e luftës.



Takim me përfaqësues nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtarë (IRZ)



Më 10 mars 2023, z. Enver Fejzullahu-Drejtor Ekzekutiv, znj. Luljete Hetemi, Udhëheqëse e Programit për Hulumtime dhe Publikime dhe znj. Valmira Pefqeli, Udhëheqëse e Programit të Trajnimit Fillestar në Akademinë e Drejtësisë zhvilluan një takim të përbashkët me znj. Frauke Bachler - Drejtoreshë e përgjithshme e IRZ-së, z. Frank Hupfeld - Drejtor për Evropën Juglindore, Sektori Bilateral dhe z. Volkmar Theobald, Drejtor i Projektit EU-KOJUST.

Qëllimi i këtij takimi ishte vazhdimi i bashkëpunimit në sferën e trajnimit gjyqësor me theks në të drejtën evropiane meqenëse Kosova

është e orientuar në integrimin Evropian dhe në anëtarësimin e strukturave të saj.

Me rastin e takimit u diskutua për aktivitetet e realizuara në mbështetje të këtij fondacioni me theks te vizitat e realizuara për gjyqtarët dhe prokurorët në gjykatat dhe prokuroritë në Bon, Trier dhe Koblenz dhe veçanërisht në Akademinë Gjermane të Drejtësisë dhe Akademinë e së Drejtës Evropiane. Lidhur me këto të fundit nga ana e drejtorit të AD-së u parashtrua nevoja e përfshirjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve Kosovar në programet, konferencat dhe format tjera të trajnimit gjyqësor që ofron ky institucion për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë tjerë ligjor për vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

Në fund të takimit nga dy palët u konfirmua bashkëpunimi edhe më tej dhe realizimi i aktiviteteve të përbashkëta për shkëmbimin profesional dhe fuqizimin e kontakteve në mes të gjykatave në rajon.



Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë

Më 28 mars 2023, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit z. Vaton Durguti, Udhëheqës i Departamentit Special në Gjykatën e Apelit.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor të Punës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2022, si dhe çështje tjera në kuadër të mandatit të Akademisë.

Sipas rendit të ditës të përcaktuar për këtë takim, fillimisht anëtarët e KD-së miratuan procesverbalin e takimit të kaluar të KD-së dhe më pas Drejtori Ekzekutiv i Akademisë, prezantoi në pika të shkurta Raportin Vjetor të Punës të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2022.

Anëtarët e Këshillit Drejtues, duke vlerësuar punën e Akademisë gjatë vitit 2022, e miratuan në mënyrë unanime raportin e prezantuar.

Gjithashtu, në këtë takim Drejtori Ekzekutiv i njoftoi anëtarët e KD-së për ftesën nga Shkolla Kombëtare e Magjistraturës në Francë (ENM) drejtuar Akademisë së Drejtësisë, për pjesëmarrje si anëtare në projekt për drejtësinë për të mitur, në kuadër të Programit të Drejtësisë të Komisionit Evropian, me ç' rast anëtarët e KD-së dhanë pëlqimin për pjesëmarrje të AD-së në këtë projekt në partneritet me EMM.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar, (gjenerata e IX)- 2022-2023



Gjatë muajit mars, për 5 prokurorët e kësaj gjenerate janë realizuar 16 sesione të trajnimit teorik si dhe 15 ditë të trajnimit praktik.

Sesionet e trajnimit teorik ishin nga moduli Kodi i procedurës penale dhe nën modulet: Roli i prokurorit në fazën e shqyrtimit gjyqësor, Shqyrtimi fillestar dhe i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor, Procedurat e veçanta sipas KPPK si dhe nga nën moduli: Ushtrimi i mjeteve juridike.

Nga nën moduli: “Procedurat alternative” janë realizuar 5 sesione, trajnuese dhe janë trajtuar: negociimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë, lirimi nga dënimi, dëshmitarët bashkëpunues, kërkesa për shpalljen e personit dëshmitarë bashkëpunues dhe kushtet kur ndjekja nuk është e detyrueshme.

Nga nën moduli: “Roli i prokurorit në fazën e shqyrtimit gjyqësor” janë realizuar 3 sesione,



nga të cilat janë trajtuar: roli i prokurorit në shqyrtimin gjyqësor, marrja e drejtpërdrejte, marrja e tërthorët dhe rimarrja në pyetje e dëshmitarit dhe roli i prokurorit në fjalën përfundimtare.

Në kuadër të nën modulit: “Shqyrtimi fillestar dhe i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor” janë realizuar 4 sesione trajnuese ku janë trajtuar: shqyrtimi fillestar, kundërshtimi i provave, kërkesa për hedhjen e aktakuzës në shqyrtimin gjyqësor dhe shqyrtimi gjyqësor.

Nga nën moduli: “Procedurat e veçanta sipas KPPK” janë realizuar 3 sesione, ku janë trajtuar: procedura gjyqësore ndaj personave të cilët kanë kryer veprë penale nën ndikim të drogës apo alkoolit, paraburgimi, procedura për dhënien e urdhrit ndëshkimorë.

Dhe në kuadër të nën modulit: “Ushtrimi i mjeteve juridike” është realizuar 1 sesion, nga i cili është trajtuar përpilimi i ankesës nga prokurori i shtetit.

Për të gjitha nën modulet e lartë përmendura përveq shpjegimeve në detaje për specifikat dhe veçoritë që i karakterizojnë veprimet dhe procedurat përkatëse janë ilustruar edhe me raste praktike duke iu mundësuar prokurorëve të ofrojnë edhe perspektivën e tyre.



Trajnimi praktik për gjyqtarët e sapo emëruar, (gjenerata e IX)- 2022-2023

Gjatë muajit mars, 45 gjyqtarët e gjeneratës së IX kanë vijuar sesionet e trajnimit praktik në gjykatat përkatëse ku janë të emëruar.

Gjatë kësaj periudhë janë realizuar gjithsej 23 ditë trajnimi praktik, pjesë kjo e trajnimit e cila është realizuar nën mbikëqyrjen e gjyqtarit/mentor.

Në kuadër të këtij trajnimi, gjyqtarët nën mbikëqyrjen e gjyqtarit mentorë kanë shqyrtuar lëndët dhe kanë asistuar në të gjitha aktivitetet gjyqësore të planifikuara për muajin mars duke

ndërmarrë veprimet e duhura për lëndët përkatëse me rastin e praktikës.

Mentorët kanë qenë të koordinuar me Akademinë e Drejtësisë në përmbushje të trajnimit praktik sipas kompetencave të përcaktuara me Programin Trajnues.

Gjithashtu vijueshmëria e tyre në trajnimin praktik gjatë muajit ka qenë e rregullt dhe me këtë është përmbush trajnimi praktik sipas kalendarit trajnues.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnimi: Bashkëndërgjyqësia

Më 01 Mars 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Bashkëndërgjyqësia”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve për institutin e bashkëndërgjyqësisë, përkatësisht për pozitën procedurale, për vlerësimin adekuat për veprimet e bashkëndërgjyqësve si dhe pasojat që krijojnë këto veprime për bashkëndërgjyqësit tjerë. Gjithashtu edhe për veprimet procedurale që duhet ti marrin në rastet kur paraqiten ndërhyrësit dhe varësisht nga cilësia e ndërhyrësit të zhvillojnë procedurën dhe të vendosin në mënyrë meritore në përputhje me dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore. Gjatë trajnimit është diskutuar për rastet në të cilat mund të paraqiten disa paditës apo të paditur; Mundësia e bashkëngjijtes në padi gjatë procedurës nga paditësi tjetër; Mundësia e zgjerimit të padisë ndaj të paditurve tjerë; Të paditurit eventual; Ndërhyrja kryesore në procedurë; Bashkëndërgjyqësit unik; Mundësitë dhe të drejtat për propozime lidhur me drejtimin e procesit gjyqësor.

Fokusi i trajnimit në çështjet e theksuara më lartë ishte aspekti praktik, sfidat dhe modalitetet që duhet ndjekur për një praktikë më të mirë e cila u realizua përmes diskutimit interaktiv shumë profesional dhe përmes rasteve praktike për diskutim.

Me rastin e këtij trajnimi përmes rasteve praktike janë sqaruar dilemat që i referohen identifikimit të bashkëndërgjyqësisë, rolit të gjykatës, vendimi i gjykatës në kontestet ku ekzistojnë lloje të ndryshme të bashkëndërgjyqësve, dallimet konceptuale dhe praktike në mes të bashkëndërgjyqësve dhe ndërhyrësve si dhe elementet e përbashkëta në mes tyre.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 44 gjyqtarë, prej tyre 2 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, 5 nga Gjykata e Apelit dhe 37 gjyqtarë tjerë nga niveli themelor i gjykatave nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Trajnim: Arsyetimi gjyqësor dhe të drejtat e njeriut

Më 02 Mars 2023, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme është duke realizuar trajnimin me temë “Arsyetimi gjyqësor dhe të drejtat e njeriut”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve për rregullat e arsyetimit dhe shkrimit ligjor në përputhje me standardet e unifikuara të arsyetimit dhe shkrimit ligjor dhe zbatimi i teknikave të interpretimit të çështjeve ligjore në praktikë për përmirësimin e cilësisë së shkrimit dhe arsyetimit ligjor në punën e tyre.

Gjatë këtij trajnimi u diskutuan rregullat bazë të shkrimit të akteve dhe dokumenteve ligjore me theks te procesi i të shkruarit, parimet e të shkruarit ligjor, dhe metoda katër hapeshe e arsyetimit ligjor e njohur si IRAC e cila u

elaborua edhe në procedurën penale duke përfshirë gjykimin, ankesën dhe ekzekutimin e vendimit gjyqësor si dhe në procedurën civile me fokus te parimet e përgjithshme dhe çështjet tematike.

Me rastin e diskutimit të çështjeve të lartpërmendura u ofruan udhëzime praktike përmes rasteve nga praktika gjyqësore dhe instruksioneve për qasjen në çështjet juridike, si duhet të realizohet hulumtimi i resurseve për çështjen që është objekt shqyrtimi, si duhet të realizohet analiza ligjore dhe standardet që duhet pasur në konsideratë me rastin e shkrimit dhe arsyetimit ligjor.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 22 gjyqtarë, 2 prokurorë si dhe 4 bashkëpunëorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave.



Trajnim: Ndërmjetësimi (Civile), Regjioni Prizren-Gjakovë

Më 07 mars 2023, në bashkëpunim me Programin me Programin e USAID – Drejtësia Komerciale, implementues DEXIS, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Ndërmjetësimi në aspektin Civil”, për gjyqtarët dhe ndërmjetësit e regjionit të Prizrenit dhe Gjakovës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe ndërmjetësuesve për metodën alternative të zgjidhjes së kontesteve ndërmjet dy apo më shumë personave në çështjet civile dhe rolin e ndërmjetësuesit, si person i tretë, i pavarur dhe i paanshëm, i cili nuk ka autoritet apo fuqi për të marrë vendime për palët por që vetëm ndihmon palët përmes bisedave, të arrijnë të zgjidhje lidhur me mosmarrëveshjen që kanë në mes veti.

Gjatë trajnimit u diskutua për Ndërmjetësimin e detyrueshëm; Procedurën e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të Ndërmjetësimit; Procedurën e ndërmjetësimit, Marrëveshja e ndërmjetësimit; Ndërmjetësuesn dhe roli dhe

përgjegjësia e tij në raste praktike.

Vëmendje të veçantë kishte edhe referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit që është në diskrecionin e gjyqtarëve duke mos anashkaluar vullnetin e palëve në kontest dhe në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore. Ky trajnim shërbeu si orientim për gjyqtarët dhe stafin tjetër të gjykatave dhe prokurorive për identifikimin më të lehtë të kontesteve të përshtatshme për tu zhvilluar në procedurë të ndërmjetësimit, si dhe lëndët e tjera për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 3 gjyqtarë, 11 ndërmjetësues, 8 bashkëpunëtorë profesional, 1 zyrtarë për informim, 1 përkthyes, 1 administratorë dhe 1 praktikantë nga regjioni i Prizrenit dhe Gjakovës.



Trajnim: Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkuro-rëzimit dhe në rastet e dhunës në familje



Më 14-15 Mars 2023, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka organizuar dhe mbajtur trajnimin dyditor me temë “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkuro-rëzimit dhe në rastet e dhunës në familje”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës familjare.

Në ditën e parë u trajtuan: Parimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit vendor; Dhuna në familje, Urdhri për mbrojtje dhe procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje. Ndërsa në ditën e dytë u trajtuan: Llojet e masave mbrojtëse dhe kohëzgjatja e tyre, ekzekutimi dhe pasojat e mos ekzekutimit të urdhrit për mbrojtje.

Trajnimi adresoj sfidat e praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës familjare. Gjithashtu u zbërthyen mënyrat dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore, parimi i interesit më të lartë të fëmijës, roli i gjykatës dhe organit të kujdestarisë në procedurat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre si dhe legjislacioni i zbatueshëm vendor përfshirë këtu edhe risitë e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Trajnimi u ofrua në formë të tryezës dhe trajtoj çështjet duke prezantuar sfidat e identifikuara në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat u prezantuan përmes rasteve konkrete. Raste e prezantuara ishin të përzgjedhura nga fusha përkatëse që ndërlidheshin me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre. Rastet e përzgjedhura nga praktika gjyqësore prezentuan në mënyrë objektive problematikën e çështjeve por edhe mënyrën se si duhet të vepohet në të ardhmen.

Në trajnim u theksua se në pjesën e pestë të Ligjit për Familjen rregullohen format e veçanta për mbrojtjen e fëmijëve që nuk kanë kujdes prindëror, mënyra se si zbatohen këto forma dhe parimet themelore lidhur me atë se cilët fëmijë konsiderohen pa përkujdesje prindërore dhe cilat janë format ligjore që ligji i quan forma të veçanta për mbrojtjen e këtyre fëmijëve.

Pas diskutimit të gjerë u konkludua se vendimi mbi zbatimin e cilësdo formë të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror merret pas shqyrtimit të hollësishëm të secilit rast individualisht, ndërsa organi kompetent do të nxjerrë përfundim për formën e mbrojtjes së familjes për fëmijën që i plotëson kërkesat e fëmijës në masë më të madhe.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive, prezantim i çështjeve përmes rasteve nga praktika gjyqësore, diskutim për rastet dhe ofrimi i konkluzave për çështjen e diskutuara.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 36 gjyqtarë, prej tyre 1 nga Gjykata Supreme, 4 nga Gjykata e Apelit dhe 31 gjyqtarë tjerë nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regionet.

Trajnim: Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve - Regjioni Mitrovicë

Më 14 mars 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim EULEX është realizuar trajnimi me temë “Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve” për regjionin e Mitrovicës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të kuadrit ligjor të regjionit të Mitrovicës për rastet e dhunës gjinore, me theks të veçantë abuzimit të fëmijëve për trajtimin e duhur dhe vendosjen meritorë të rasteve përkatëse në përputhje me dispozitat ligjore dhe standardet për të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi.

Si fillim trajnimi u fokusua në të kuptuarit e drejtë të dhunës gjinore, përkatësisht keqpërdorimit dhe dhunës seksuale ndaj fëmijëve si një nga format më të këqija të abuzimit ndaj fëmijëve. Në këtë vështrim vëmendje e veçantë i është kushtuar kornizës ligjore vendore dhe ndërkombëtare të cilat e kriminojnë keqpërdorimin e fëmijëve duke e cilësuar si shkelje të drejtëpërdrejtë të të drejtave të njeriut. Më tej u diskutua edhe për shqetësimet fizike dhe emocionale që fëmijët i

pësojnë dhe shpesh edhe humbje të parëvokueshme të dinjitetit dhe vetëbesimit nga dhuna seksuale dhe format tjera të abuzimit.

Pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë edhe për raste praktike që nga fillimi i raportimit për keqpërdorimin të fëmijëve e deri në verdiktin final nga gjykata duke vënë në pah sfidat dhe modalitetet për një praktikë më të mirë.

Me interes ishte edhe perspektiva e shtetit të Finlandës në rastet e tilla dhe krahasimi i praktikës gjyqësore me Kosovën si dhe shkëmbimi i përvojave

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 1 prokuror, 2 avokatë, 1 mbrojtës i viktimave, 1 zyrtarë nga Qendra për Punë Sociale, 6 zyrtarë policor, si dhe 1 zyrtarë i lartë për bashkëpunim profesional nga Prokuroria.



Punëtorja: Qasja në dokumente publike të cilat i posedon policia dhe institucionet e drejtësisë

Më 15 Mars 2023, në bashkëpunim me Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe EULEX në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar punëtorja me temë “Qasja në dokumente publike të cilat i posedon policia dhe institucionet e drejtësisë”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor lidhur me Kornizën Kushtetuese dhe ligjore për qasjen në dokumente publike përfshirë qasjen në dokumente publike të cilat i posedon gjykata, prokuroria dhe policia dhe institucionet e drejtësisë për zbatimin në praktikë në përputhje me legjislationin në fuqi.

Në këtë punëtori në mënyrë të hollësishme u trajtua Ligji për Qasje në Dokumente Publike dhe zbatimi i tij në kuadër të sistemit të drejtësisë, përkatësisht qasja në dokumente publike në polici, prokurori dhe në gjykata. Vëmendje e veçantë i është kushtuar rasteve

konkrete të cilat kanë ndërtuar praktika pozitive dhe situatat në të kaluarën kur dokumentet publike nuk i ishin dhënë publikut derisa ishte ndërtuar qasje pozitive pas ndjekjes së rrugëve ligjore dhe nxjerrjes së vendimeve përkatëse.

Gjatë kësaj punëtorie pati diskutim lidhur me obligimin ligjor për publikim proaktiv të dokumenteve publike duke prezantuar shembuj konkret mbi dobitë e publikimit proaktiv për punën e përditshme të gjykatave, prokurorive dhe policisë.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin 52 pjesëmarrës. Prej tyre 1 gjyqtar, 3 prokuror, 34 staf administrativ nga radhët e zyrtarëve për informim, zyrtarë të lartë për bashkëpunim profesional, bashkëpunëtorë profesional, referentë dhe administratorë si dhe 12 policë dhe inspektor policor dhe 2 të tjerë nga KGJK dhe KPK, Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia për Forenzikë.



Punëtori - Unifikimi Praktikes Gjyqësore

Më 16-17 mars 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar punëtorja për unifikimin e praktikës gjyqësore në çështje civile dhe administrative.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte identifikimi i praktikës gjyqësore jo unike në çështjet civile dhe administrative dhe ofrimi i praktikave më të mira në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe unifikimi i praktikës gjyqësore.

Fokusi i punëtorisë ishte në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve aktuale sa i përket praktikës gjyqësore në procedurën kontestimore, në çështjet lidhur me fitimin e pronësisë me parashkrim fitues në pronën shoqërore, në çështjet e kompensimit të dëmit lidhur me institutin e parashkrimit të kërkesave dhe në kontestet martesore.

Të gjithë gjyqtarët e pranishëm u pajtuan që unifikimi i praktikës gjyqësore për çështjet e identifikuar të bëhet nga vetë gjyqtarët dhe si

rrjedhojë e gjithë punëtorja është zhvilluar në grupe të ndara. Secili nga grupet kanë hartuar propozimet lidhur me unifikim e praktikës gjyqësore, duke i dhënë arsyet për propozimet e parashtruara.

Për dy ditë me radhë gjyqtarët pjesëmarrës ofruan 27 propozime ku më pas janë vënë në diskutim nga gjyqtarët dhe Kolegjiumi i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit-Divizioni Civil dhe si përfundim kanë arritur pajtueshmëri dhe konkluzionet se si të vendoset në të ardhmen për 12 prej tyre.

Ndërkaq për 15 të tjera mbeten të trajtohen në tryezën e radhës dhe të njëjtat sapo të finalizohen do të publikohen nga AD dhe të jenë të qasshme për gjithë gjyqtarët dhe komunitetin tjetër ligjor.

Këtë punëtori e vijuan 18 gjyqtarë nga Gjykata e Apelit dhe 1 bashkëpunëtorë profesional i kësaj gjykate.



Trajnim: Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve - Regjioni Pejë

Më 16 mars 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim EULEX është realizuar trajnimi me temë “Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve” për regjionin e Pejës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të kuadrit ligjor të regjionit të Pejës për rastet e dhunës gjinore, me theks të veçantë abuzimit të fëmijëve për trajtimin e duhur dhe vendosjen meritorë të rasteve përkatëse në përputhje me dispozitat ligjore dhe standardet për të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi.

Si fillim trajnimi u fokusua në të kuptuarit e drejtë të dhunës gjinore, përkatësisht keqpërdorimit dhe dhunës seksuale ndaj fëmijëve si një nga format më të këqija të abuzimit ndaj fëmijëve. Në këtë vështrim vëmendje e veçantë i është kushtuar kornizës ligjore vendore dhe ndërkombëtare të cilat e kriminojnë keqpërdorimin e fëmijëve duke e cilësuar si shkelje të drejtpërdrejtë të të drejtave të njeriut. Më tej u diskutua edhe për shqetësimet fizike dhe emocionale që fëmijët i

pësojnë dhe shpesh edhe humbje të parevokueshme të dinjitetit dhe vetëbesimit nga dhuna seksuale dhe format tjera të abuzimit.

Pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë edhe për raste praktike që nga fillimi i raportimit për keqpërdorimin të fëmijëve e deri në verdiktin final nga gjykata duke vënë në pah sfidat dhe modalitetet për një praktikë më të mirë.

Me interes ishte edhe perspektiva e shtetit të Finlandës në rastet e tilla dhe krahasimi i praktikës gjyqësore me Kosovën si dhe shkëmbimi i përvojave

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin 16 pjesëmarrës. Prej tyre 1 prokuror 6 zyrtarë nga Qendra për punë sociale, 6 zyrtarë policor , 1 avokat si dhe 2 mbrojtës të viktimave.



Trajnim i avancuar për parandalimin e dhunës në familje- Konventa e Stambollit

Më 20 mars 2023, në bashkëpunim me Organizatën Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal – CLARD dhe IKD, është realizuar “Trajnimi i avancuar për parandalimin e dhunës në familje- Konventa e Stambollit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të njoftohen me konceptet themelore të Konventës së Stambollit dhe standardet e saj në luftimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe zbatimi praktik i saj në rastet përkatëse.

Me rastin e këtij trajnimi u elaboruan në mënyrë të hollësishme instrumentet kryesore që kriminojnë dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, përkatësisht KEDNJ dhe Konventa e Stambollit e Këshillit të Evropës të cilat janë zbatueshme në Kosovë . Nga diskutimet u vu në pah se dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave paraqet shkeljen më të rëndë me bazë

gjinore dhe që trajtimi i tyre i këtyre rasteve kërkon përkujdesje të veçantë meqë shumica e tyre mbulohen me heshtje.

Gjatë trajnimit u elaboruan raste të ndryshme nga praktika gjyqësore qoftë vendore ashtu edhe nga praktika e GJEDNJ-së për të cilat pjesëmarrësit kishin për detyrë të përgjigjeshin në pyetjet se autoritetet kompetente në rastet përkatëse kishin kryer veprimet e duhura apo kishin dështuar dhe në këtë mënyrë të zgjedhin praktikatat më të mira.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar me raste praktike. Përfitues të këtij trajnimi ishin: 6 Avokatë nga gjitha regjionet e Kosovës, 1 Zyrtarë për Mbrojtjen e Viktimave si dhe 1 zyrtarë policor.



Trajnim: Hetimi financiar dhe kthimi i pasurisë



Më 20-24 mars 2023, në mbështetje të UNDP/ SAEK 3 dhe Institutin e Bazellit për Qeversije në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Hetimi Financiar dhe Rikuperimi i Aseteve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me gjurmimin e asetëve dhe organizimin e provave me rastin e hetimeve financiare dhe rikuperimit të asetëve .

Në ditë e parë dhe të dytë trajnimi u fokusua kryesisht në trajtimin e aspekteve të rëndësishme të pastrimit të parave, gjurmimit të asetëve, organizimit të provave elektronike dhe elementeve të krimit në kontekst të

legjislacionit vendor .

Në ditën e tretë dhe të katërt trajnimi u fokusua në qasjet hetimore financiare me theks te metoda indirekte për vërtetimin e të hyrave të paligjshme dhe ndihmën e ndërsjelltë juridike si dhe në mekanizmat për konfiskim të asetëve.

Për katër ditë me radhë pjesëmarrësit patën mundësinë e ushtrimeve praktike për gjurmim të asetëve dhe në këtë mënyrë edhe të diskutojnë problematikat eventuale dhe të shkëmbejnë praktikatat më të mira në rastet përkatëse.

Në ditën e pestë trajnimi u përqendrua në përgatitjet dhe prezantimet e pjesëmarrësve për rastet studimore.

Metodologjia e trajnimit është e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike. Përfitues të këtij trajnimi ishin 4 gjyqtarë, 8 prokurorë, 1 bashkëpunëtorë profesionale si dhe 3 zyrtarë policor.



Trajnim për praktikat gjyqësore në çështje familjare



Më 21-22 mars 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi dyditor me temë: “Trajnim për praktikat gjyqësore në çështje familjare”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve për adresimin e sfidave të praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës familjare.

Në ditën e parë u trajtuan temat si: Anulimi i Martesës; Zgjidhja e martesës; Procedura e shkurorëzimit, Detyrimi për ushqim dhe e drejta prindërore; dhe Format e veçanta të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror. Ndërsa në ditën e dytë u trajtuan: Kundërshtimi dhe vërtetimi i amësisë apo i atësisë; Marrëdhëniet pasurore në mes bashkëshortëve; dhe roli i së drejtës evropiane dhe praktikës gjyqësore të GJDBE ne Luxemburg. Veçmas u trajtua Konventa për të Drejtat e Fëmijës e AP të OKB (1989).

Ky trajnim adresoj sfidat e praktikës gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave materiale dhe procedurale nga fusha e së drejtës familjare. Në Republikën e Kosovës e drejta familjare si tërësi është rregulluar me Ligjin e Familjes, i cili në vitin 2019, ka pasuar disa ndryshime lidhur me mënyrën e llogaritjes së kontributit të bashkëshortëve, mirëpo në të njëjtën kohë

praktika gjyqësore ka njohur zhvillimin e saj në trajtimin e rasteve nga marrëdhëniet martesore dhe familjare e të cilat u trajtuan në kuadër të kësaj tryeze.

Në trajnim u potencua se çështjet familjare zakonisht janë sensitive dhe kërkojnë përkushtim dhe profesionalizëm të nivelit të lart në trajtimin e rasteve sipas kërkesave për mbrojtje gjyqësore, dhe në këtë tryezë u adresuan problematikat lidhur me zbatimin e Ligjit për Familjen i Kosovës, legjislacionit tjetër vendor dhe atij ndërkombëtar në këtë lëmi.

Në trajnim vend të konsiderueshëm iu kushtua edhe zbatimit të së drejtës evropiane dhe vendimeve të GJEDNJ-së ne Luxemburg që kane të bëjnë përveç me shtetet anëtare të BE-së edhe me shtetet e treta, siç është Republika e Kosovës. E drejta evropiane u theksua se parasheh barazi dhe të drejta kualitative apo zgjidhje kualitative. U sqarua se Ligji i ri për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile dhe Ligji për të Drejtën Ndërkombëtar Private që kanë hyrë në fuqi në vitin 2022 përmbajnë të transponuar konventat, rregulloret dhe urdhëresat e BE-së, si dhe disa institute të lëmis juridike-familjare, statusore dhe trashëgimore që janë të njëjta me ato të BE-së.

Trajnimi u ofrua në formë të tryezës dhe trajtoj çështjet që përfshihen në kuadër të fushës së marrëdhënieve martesore dhe familjare. Trajtimi i çështjeve u bë duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat u prezantuan përmes rasteve konkrete. Rastet e përzgjedhura nga praktika gjyqësore prezantuan në mënyrë objektive problematikën e çështjeve por edhe mënyrën se si duhet të veprohet në të ardhmen. Shpjegimet që ofruan trajnuesit në tryezë u mbështetën në konceptet ligjore të rregullimit të marrëdhënieve familjare dhe në praktikën gjyqësore e dispozitat ligjore në fuqi.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të

kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive, prezantim i çështjeve përmes rasteve nga praktika gjyqësore të ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjen që trajtua. Në çdo rast të trajtuar trajnuesit kishin në konsideratë aspektet faktike dhe juridike duke ofruar përgjigje konkrete. Trajnuesit për rastet e ndërlidhura me temën e sesionit ofruan pikëpamjet e tyre, perspektiven ligjore dhe atë të praktikës gjyqësore si mbështetje për përfundimet e tyre.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 22 gjyqtarë, prej tyre 1 nga Apeli dhe 21 tjerë nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Trajnim: Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve - Regjioni Prizren

Më 21 mars 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim EULEX është realizuar trajnimi me temë “Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve” për regjionin e Prizrenit

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të kuadrit ligjor të regjionit të Prizrenit për rastet e dhunës gjinore, me theks të veçantë abuzimit të fëmijëve për trajtimin e duhur dhe vendosjen meritorë të rasteve përkatëse në përputhje me dispozitat ligjore dhe standardet për të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi.

Si fillim trajnimi u fokusua në të kuptuarit e drejtë të dhunës gjinore, përkatësisht keqpërdorimit dhe dhunës seksuale ndaj fëmijëve si një nga format më të këqija të abuzimit ndaj fëmijëve. Në këtë vështrim vëmendje e veçantë i është kushtuar kornizës ligjore vendore dhe ndërkombëtare të cilat e kriminojnë keqpërdorimin e fëmijëve duke e cilësuar si shkelje të drejtëpërdrejtë të të drejtave të njeriut. Më tej u diskutua edhe për

shqetësimet fizike dhe emocionale që fëmijët i pësojnë dhe shpesh edhe humbje të përvokueshme të dinjitetit dhe vetëbesimit nga dhuna seksuale dhe format tjera të abuzimit.

Pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë edhe për raste praktike që nga fillimi i raportimit për keqpërdorimin të fëmijëve e deri në verdiktin final nga gjykata duke vënë në pah sfidat dhe modalitetet për një praktikë më të mirë.

Me interes ishte edhe perspektiva e shtetit të Finlandës në rastet e tilla dhe krahasimi i praktikës gjyqësore me Kosovën si dhe shkëmbimi i përvojave

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin 14 pjesëmarrës. Prej tyre 1 gjyqtarë, 2 prokurorë, 2 zyrtarë për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave, 6 zyrtarë policor, 1 zyrtarë nga Qendra për Punë Sociale si dhe 2 avokat nga regjioni i Prizrenit.



Program i Specializuar i Trajnimit - Krimi Kibernetik dhe kriptovalutat – Sesioni I

Më 22-23 mars 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Program i Specializuar i Trajnimit - Krimi Kibernetik dhe kriptovalutat – Sesioni I”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për Krimin kibernetik si vepër penale në legjislacionin e brendshëm, procedurën dhe praktikën në lidhje me provat elektronike për vendosjen meritorë të rasteve përkatëse.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan temat: Krimi kibernetik – tendencat dhe instrumentet; Teknologjia e përfshirë në krimin kibernetik; Bashkëpunimi vendor; Veprat penale të krimit kibernetik në legjislacionin e brendshëm – pornografia e fëmijëve; Legjislacioni, procedura dhe praktika në lidhje me provat elektronike dhe raste praktike.

Fokus të theksuar në këtë trajnim ishin sfidat që hasin prokurorët dhe gjyqtarët gjatë trajtimit të rasteve të krimit kibernetik, zbatimi i dispozitave materiale në përgjithësi, e në veçanti vepra penale: pornografia me fëmijë, gjegjësisht të gjitha format e kryerjes së kësaj vepre por edhe veprat penale të shfrytëzimit seksual ku subjekt janë fëmijët (ndjeshmëria

dhe rëndësia e tyre), bashkëpunimin me ofruesit e shërbimeve, ruajtja e përsheptuar e të dhënave të rastet urgjente, si dhe parashtrimin e kërkesave për ndihmë juridike-ndërkombëtare.

Gjyqtarët dhe prokurorët janë njoftuar me Ligjet e veçanta që rregullojnë këtë materie, në veçanti edhe me dispozitat e Ligjit për Komunikime elektronike, që kanë të bëjnë me kompetencat dhe detyrimin e ofruesve të shërbimeve për të bashkëpunuar me zbatuesit e ligjit, për të zbatuar urdhrat e prokurorisë dhe gjykatës, për afatet e përcaktuara kohore të përcaktuara në këtë Ligj dhe mënyrën e bashkëpunimit ndërinstytucional. Nga pjesëmarrësit është kërkuar që të jenë më aktiv gjatë zbatimit të procedurës, jo vetëm për shkak se duhen marrë në konsideratë afatet kohore të përcaktuara, por edhe për fatin se të dhënat apo provat janë elektronike që shumë lehtë mund të humben, shkatërrohen dhe zhduken nëse nuk veprohet shpejtë, në mënyrën dhe metodën e duhur.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 3 gjyqtarë dhe 2 prokuror të nivelit themelor.



Trajnim: Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve - Gjilan

Më 23 mars 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim EULEX është realizuar trajnimi me temë “Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve” për regjionin e Gjilanit

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të kuadrit ligjor të regjionit Gjilanit për rastet e dhunës gjinore, me theks të veçantë abuzimit të fëmijëve për trajtimin e duhur dhe vendosjen meritorë të rasteve përkatëse në përputhje me dispozitat ligjore dhe standardet për të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi.

Si fillim trajnimi u fokusua në të kuptuarit e drejtë të dhunës gjinore, përkatësisht keqpërdorimit dhe dhunës seksuale ndaj fëmijëve si një nga format më të këqija të abuzimit ndaj fëmijëve. Në këtë vështrim vëmendje e veçantë i është kushtuar kornizës ligjore vendore dhe ndërkombëtare të cilat e kriminojnë keqpërdorimin e fëmijëve duke e cilësuar si shkelje të drejtpërdrejtë të të drejtave të njeriut. Më tej u diskutua edhe për

shqetësimet fizike dhe emocionale që fëmijët i pësojnë dhe shpesh edhe humbje të paravokueshme të dinjitetit dhe vetëbesimit nga dhuna seksuale dhe format tjera të abuzimit.

Pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë edhe për raste praktike që nga fillimi i raportimit për keqpërdorimin të fëmijëve e deri në verdiktin final nga gjykata duke vënë në pah sfidat dhe modalitetet për një praktikë më të mirë.

Me interes ishte edhe perspektiva e shtetit të Finlandës në rastet e tilla dhe krahasimi i praktikës gjyqësore me Kosovën si dhe shkëmbimi i përvojave

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin 9 pjesëmarrës. Prej tyre 1 prokuror, 1 zyrtarë për mbrojtje dhe ndihmë të viktimave, 6 zyrtarë policor si dhe 1 zyrtarë nga Qendra për Punë Sociale

Trajnim: Vlerësimi i Rrezikshmërisë në Rastet e Dhunës në Familje

Më 27 Mars 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim me OPDAT është realizuar trajnimi me temë “Vlerësimi i Rrezikshmërisë në Rastet e Dhunës në Familje”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të mbrojtësve të viktimave dhe zyrtarëve policor lidhur me procedurat dhe mjetet për vlerësimin e rrezikut në rastet e dhunës në familje në mënyrë që kryesit e dhunës të mbahen përgjegjës dhe viktimat të gëzojnë mbrojtjen e duhur nga institucionet përkatëse.

Trajnimi në fillim u fokusua në shpjegimet e hollësishme sa i përket kushteve të caktimit të paraburgimit, trajtimit të viktimave, komunikimit ndër institucional, mbrojtjes së viktimave, për faktorët lehtësues dhe rëndues si dhe për indikatorët e rrezikut në rastet e dhunës

në familje. Vëmendje e veçantë iu kushtua vështirësive dhe sfidave të praktikës gjyqësore të cilat u diskutuan nga ana e mbrojtësve të viktimave dhe zyrtarëve policor përmes të cilave ofruan zgjidhjet më të mira ligjore.

Në trajnim vend të konsiderueshëm iu kushtua edhe perspektivës së SHBA-ve përmes ofrimit të shembujve nga praktika.

Metodologjia e zbatuar është e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 5 Zyrtar nga Zyra për Mbrojtjen e Viktimave dhe 11 zyrtar Policor.



Trajnim: Aplikimi i masave të diversitetit, sfidat dhe pengesat në implementim

Më 28 Mars 2023, në bashkëpunim me EULEX në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar punëtorja me temë “Aplikimi i masave të diversitetit, sfidat dhe pengesat në implementim”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor pjesëmarrës lidhur me Kornizën ligjore për caktimin e Masave të Diversitetit dhe zbatimimi në praktikë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në këtë punëtori nga trajnuesit në mënyrë të hollësishme u shtjelluan masat e diversitetit, duke theksuar që sipas KDM-se janë gjithsej 16 masa të diversitetit që mund të ju shqiptohen të miturit varësisht nga natyra e veprës penale duke potencuar masën e diversitetit të vërejtjes policore e cila në Kodin paraprake nuk ka qenë e parashikuar dhe gjithashtu edhe mënyra e

aplikim të saj me rastin e vendosjes nga ana e Prokurorit të Shtetit.

Pjesëmarrësit në këtë punëtori patën mundësinë të diskutojnë për kushtet dhe mënyrën e vendosjes me rastin e përcaktimit të llojit të masave të diversitetit si dhe çfarë duhet të përmbajë masa e diversitetit-verejtja policore gjatë hartimit nga ana e zyrtarit policor meqenëse e njëjta duhet të nxirret dhe mbikëqyrët nga ana policisë së Kosovës.

Metodologjia e punëtorisë ishte karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin: 4 gjyqtarë, 6 prokurorë, 6 zyrtarë policor, 2 zyrtarë nga Shërbimi Sprovues, dhe 2 praktikantë



Trajnim: Mbrojtja dhe siguria e gazetarëve

Më 29-30 Mars 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Mbrojtja dhe siguria e gazetarëve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve për mbrojtjen gjyqësore në rastet e cenimit të sigurisë së gazetarëve në përputhje me e standardet e BE-së për të drejtat e njeriut të cilat janë njëkohësisht pjesë përbërëse e legjislacionit tonë vendor.

Për dy ditë me radhë u trajtuan detyrimet e shtetit për mbrojtjen e aktivitetit gazetaresk dhe medias. Vëmendje e veçantë i është kushtuar instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve me theks te Rezoluta Parlamentare e Këshillit të Evropës mbi sulmet kundër gazetarëve, Rekomandimet e Këshillit

të Ministrave të Këshillit të Evropës për mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve dhe akterëve medial si dhe Deklarata e Komitetit të Ministrave.

Me rastin e këtij trajnimi pjesëmarrësit patën mundësinë e diskutimit të rasteve nga jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe vendimet e ndryshme nga kjo gjykatë të cilat u konfirmuan nga të gjithë pjesëmarrësit si praktikat më të mira në këtë fushë që duhet ndjekur edhe nga gjykatat tona vendore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 12 Bashkëpunëtorët profesional, prej tyre 9 nga gjykatat dhe 3 nga prokuroritë nga regjionet e ndryshme.



Trajnim: Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale, mundësitë dhe sfidat

Me 29 mars 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale, mundësitë dhe sfidat”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e ndihmës juridike ndërkombëtare përkatësisht rreth ekstradimit, transferimit të lëndës, sigurimit të provave dhe kërkesave tjera në çështjet penale për të rritur efikasitetin në ekzekutimin e kërkesave për ndihmë juridike sipas standardeve më të mira ndërkombëtare në bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë.

Trajnimi në fillim u fokusua në shpjegimet e hollësishtme sa i përket rolit dhe rëndësisë së bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë për vënien e drejtësisë të rasteve kur krimi i ka tejkaluar kufijtë e brendshëm dhe ka marrë dimensionin ndërkombëtarë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar kornizës ligjore aktuale dhe mekanizmave tjerë për bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë siç është Departamenti për BJN në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, koordinatorët nga gjykatat dhe prokuroritë si dhe marrëveshjet që vendi ynë ka

me shtetet për bashkëpunimin juridik.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan në detaje format e bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë duke filluar nga Ekstradimi i personave të dyshuar dhe të dënuar për vepra penale në shtetin kërkues; Ndihma juridike ndërkombëtare në çështjet penale; Transferimi i procedurës penale, ekzekutimi i vendimeve të huaja, njohja e vendimeve të huaja penale, kontrollimi, ngrirja dhe konfiskimi i të ardhurave nga krimi si dhe format tjera të bashkëpunimit që praktika gjyqësore i njehë si të zakonshme në fushën penale.


Pjesëmarrësit patën mundësinë që për çdo formë të bashkëpunimit të ofrojnë perspektivën e tyre ligjore dhe problemet praktike që janë në këtë fushë që së bashku me trajnuesit të gjejnë zgjidhjet më të mira ligjore në situatat përkatëse.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 8 gjyqtarë (2 nga Apeli dhe 6 nga niveli themelor) dhe 10 prokuror të nivelit themelor.




Vijueshmëria në trajnime në PTF e shfaqur përmes grafikoneve

Gjyqtarët e sapoemëruar (gjenerata IX) Nr. i aktiviteteve të realizuara-Mars 2023




Prokuroret e sapoemëruar (gjenerata IX) -Nr. i trajnimeve të realizuara-Mars 2023




Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve



Numri i pjesëmarrjes në trajnime në bazë të Institucioneve-Mars 2023



Numri i pjesëmarrjes dhe trajnimeve të realizuara sipas fushës Mars 2023



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Murat Mehmeti" nr. 1-3, Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660